

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelistit, i përbërë nga Rezarta Schuetz kryesuese, Sokol Çomo relator, Albana Shtylla, Ina Rama, Mimoza Tasi anëtare, shpalli vendimin për çështjen nr. 7/2023, datë 14.02.2023, që i përket ankimit të Komisionerit Publik kundër vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, nr. 605, datë 21.12.2022, që lidhet me subjektin e rivlerësimit Armida Hamiti (Moçka).

Në përfundim të gjykimit, trupi gjykues, bazuar në nenin 4, pika 6 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, dhe nenet 451, shkronja “b” e 463 të Kodit të Procedurës Civile, në mënyrë unanime, vendosi:

Pushimin e shqyrtimit të çështjes në Kolegjin e Posaçëm të Apelistit që i përket ankimit të Komisionerit Publik kundër vendimit nr. 605, datë 21.12.2022 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall sot, më datë 22.07.2025, në Tiranë.

POSTUAR NGA: NJOFTIME ([HTTPS://KPA.AL/CATEGORY/NJOFTIME/](https://kpa.al/category/njoftime/)), NJOFTIME
([HTTPS://KPA.AL/CATEGORY/NJOFTIME-SQ/](https://kpa.al/category/njoftime-sq/))

< Njoftim (<https://kpa.al/njoftim-1561/>)

Njoftim (<https://kpa.al/njoftim-1562/>) >